

VENDIM
Nr.407, datë 9.6.2005

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SË GOLEMIT, QARKU FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës së Golemit, qarku Fier, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës së Golemit, miratuar me vendimin nr.512, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të komunës Golem”.

2. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe komuna e Golemit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-2	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
3-7	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive sociale-kulturore e sportive.	Në pronësi
8-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
17-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
23-68,84-86,204-206	Troje dhe hapësira	Në përdorim
69-79	Varrezat publike	Në pronësi
82-83,87-103	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile.	Në pronësi
106-129	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
134,163,169,182	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. (tokë inproduktive, kanale të treta)	Në pronësi
136-153	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë produktive).	Në përdorim
183-193	Ujësjiellës të veçantë të fshatrave Kanalizime të veçanta të fshatrave	Në pronësi
194-203,207,209-210	Rrugë vendore të brendshme dhe komunale	Në pronësi
240-241	Rrjeti i ndriçimit publik	Në pronësi

82,83,84,85,86,107	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes kombëtare.	Në pronësi
--------------------	--	------------